

MAPS - Muzeu i Artit në Hapësirën Publike prezanton onMAPS

Projekt bashkëpunimi i realizuar si një revistë dixhitale.

MAPS – Muzeu i Artit në Hapësirën Publike është krenar t’ju prezantojë **onMAPS**, një projekt bashkëpunimi i realizuar si një revistë dixhitale fokusuar në hapësirën publike i mundësuar përmes kontributeve të artistëve, arkitektëve, urbanistëve, shkrimtarëve, mendimtarve.

Emri i revistës, onMAPS vjen nga **on**-line dhe nga “**mbi**” hartën që tenton të gërshetojë idenë e hartografisë, dhe territorit me hapësirën potencialisht të pafund virtuale.

onMAPS është një koleksion veprash arti, fotografish, dokumentim performancash, projekte, still nga video, vizatime, ilustrime etj... dhe tekste që kontribuesit shkruajnë në gjuhën që dëshirojnë.

Një pikënisje për të hapur debatin mbi çfarë do të thotë në përgjithësi të punosh/ veprosh/ dhe ndërveprosh në një hapësirë të përbashkët, mbi mënyrën me të cilën është e nevojshme të ripërcaktohet çfarë kosiderojmë publike, çfarë hapësira publike i ofron komunitetit dhe si aksesohet nga ai.

Projekti nuk është një publikim periodik, numrat do të dalin kur të jenë gati dhe janë të shfletueshme në faqen tonë issue.

Tema e numrit 0 është: **Përse kemi nevojë të bëjmë art në hapësirën publike?**

Me kontributin e **Armando Lulaj, Network Nomadic Architecture, DZT, Pleurad Xhafa, Giancarlo Norese, Bora Baboçi, Eri Çobo, Fabiola Naldi.**

Koncept: **DZT**

Design: **uzinaliquida**

E lexueshme në këtë link: :

http://issuu.com/maps-museumofartinpublicspace/docs/onmaps_0

Rreth MAPS - Muzeu i Artit në Hapësirën Publike

MAPS - Muzeu i Artit në Hapësirën Publike është një platformë artistike e themeluar në vitin 2014 me qëllim promovimin e hulumtimit të artit bashkëkohor që ka si teatër, hapësirën publike në të gjitha format dhe derivatet e saj. Një muze i shpërthyer, i cili i mundëson artistëve të ftuar përballjen çdo herë me zona të ndryshme të qytetit, që përfaqësojnë konotacione historike dhe bashkëkohore të ikonografisë qytetit. MAPS është një muze që pushton / angazhohet / transformon përmes prodhimit të ekspozitave / shfaqjes së videove/ konferencave, fokusi i të cilave është gjithmonë diskutimi dhe dialogu me një territor të qytetit dhe problematikat sociale e urbane të tij. Sepse takimi me artin mund të shkaktojë tronditjen e një revolte, ose anasjelltas arti është një revoltë sepse përmban në vetvete emocionin e njerëzve dhe vendeve që takohen.

